



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1381/3 Prot.

Fier më 02.09. 2024

Lënda: Njoftim për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit, periudha e parë, për vitin mësimor 2024 – 2025.

Në zbatim të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzim nr.30, dtë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, Urdhrit nr.100, datë 25.02.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, Urdhrit nr.437, datë 20.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, shkresës me nr. 1381 prot, datë 02.09.2024 “Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2024 – 2025, ZVAP Fier ju bën me dije se aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit do të kryhet nëpërmjet platformës së aplikimit online e-albania.

**Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, në periudhën e parë mësimore është nga data 02.09.2024 – 06.09.2024 deri në orën 12:00.**

Kandidati i interesuar për zhvillimin e praktikës profesionale ngarkon në platformën online e-albania dokumentet si më poshtë:

1.
  - a. CV e aplikantit
  - b. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve universitare të ciklit të pare (Bachelor).
  - c. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të studimeve universitare të ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe/ose “Master profesional” në mësuesi.
  - d. Raporti mjeko-ligjor.
2. Dokumentet e sipërcituara janë të detyrueshme dhe duhet të jenë të skanuara nga origjinali.
3. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për tu ngarkuar në platformën online, përjashtohet nga pjesmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale.

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier

e-mail: ZVAPfier@arsimi.gov.al



Nëse kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale ngarkon në platformën aplikimit online dokumente që dyshohet se janë të falsifikuara, përjashtohet nga marrja për zhvillimin e praktikës profesionale. Rasti referohet në organet kompetente.

DREJTOR

Miglana Sofroni

*Mso*

